



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 1893 Prot.

Patos, më 20 / 06 / 2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 34, datë 20 / 06 / 2025

**PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 74, DATË 28/10/2024 "PËR
MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE PËR BASHKINË PATOS"**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54, 55, 93, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM nr. 360, datë 29.5.2019, "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", vendimi nr. 1078, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri". Tema - Kufijtë e Njësive Administrative" si dhe shkresës ASIG me nr. 647 prot., datë 11/10/2024 i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos:

1. Të miratojë ndryshimin e vendimit nr. 74, datë 28/10/2024 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale për Bashkinë Patos" sipas hartës së re bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

GRUPI I PUNËS

Boreta Murati

Sara Çobo

Franceska Gjata

JURISTE

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 1894/Prot.

Patos, më 20/06/2025

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 74, DATË 28/10/2024 “PËR
MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDTËSUAR TË KUFIJVE ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE PËR BASHKINË PATOS”**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Me vendim të Këshillit të Bashkisë me nr. 74, datë 28/10/2024 është miratuar Harta e përditësuar e kufijëve administrativo-territorialë për Bashkinë Patos sipas kërkesës së paraqitur nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ku kërkohet harta e përditësuar e kufijëve administrativo-territorial, që përcakton standardet gjeohapësinore në kuptim të pikës 2, te nenit 93, të ligjit nr. 139/2015, i cili parashikon 5 rende kufijsh administrativo-territoriale.

Si domosdoshmëri për të patur një hartë të përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorial, është punuar hartën për njësitë administrative (rendi 4) dhe fshatrave apo njësite të tjera në përbërje (rendi 5).

Me vendimin e mëparshëm është ndryshuar edhe kufiri (Rendi 3) i territorit të Bashkisë Patos, gjë e cila nuk ndryshon me vendim të Këshillit të Bashkisë, por vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave sipas legjislacionit në fuqi.

Hartat e përgatitura nga ana jonë për secilën njësi administrative të Bashkisë Patos konkretisht:


1. Njësia Administrative Patos
2. Njësia Administrative Zharrëz
3. Njësia Administrative Ruzhdie

Kufiri i paraqitur është sipas hartave të përditësuara që ne disponojmë, ndërsa për zona ende të pa azhornuara kufiri mund të jetë i ndryshueshëm.



Në hartën e mësipërme kemi paraqitur kufijtë e Bashkisë Patos, ku janë të pasqyruara të 3 (tre-ja) njësitë administrative përkatëse, theksojmë se kufiri territorial të Bashkisë Patos do të jetë i pandryshueshëm në përputhje me ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe VKM-së nr. 360, datë 29.5.2019 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kujfijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.


Kufiri i njësisë administrative Patos, qyteti dhe fshatrat në përbërje të Njësisë.



Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njësisë Administrative Patos në të cilën përfshihet: qyteti i Patosit, fshati Dukas, fshati Kuqar, fshati Grizë, fshati Banaj, fshati Rreres, fshati Rusinjë fshati Margëlliç.


Në fshatin Rreres, Rusinjë dhe Margëlliç nuk ka kaluar ende procesi i regjistrimit fillestar dhe kufiri i paraqitur mund të jetë i ndryshueshëm në momentin e azhurnimit.

Kufiri i njësisë administrative Zharrez me fshatrat përkatës.




Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njësisë Administrative Zharrez në të cilën përfshihet: fshati Zharrez, fshati Verbas, fshati Frashër, fshati Sheqishte, fshati Belinë.

Kufiri i njësisë administrative Ruzhdie me fshatrat përkatës.



Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njësisë Administrative Ruzhdie në të cilën përfshihet: fshati Ruzhdie, fshati Gjinoqarë, fshati Drenie, fshati Siqecë, fshati Kasnicë. Për fshatin Siqecë dhe Kasnicë nuk ka kaluar ende procesi i regjistrimit fillestar dhe kufiri i paraqitur mund të jetë i ndryshueshëm në momentin e azhurnimit.



Harta e përditësuar e ndarjes administrativo-territoriale, të njësive administrative për Bashkinë Patos, duke qenë në kushtet që kemi ende zona të pa azhornuara të cilat ndodhen në kufirin ndarës me bashki të tjera kufiri aktual mund të pësojë ndryshime.

1. Për sa më sipër, i kërkojmë këshillit të bashkisë miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 74, datë 28/10/2024 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale për Bashkinë Patos”, hartës së përditësuar të ndarjes administrativo-territoriale, për rendin 4 dhe rendin 5.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet : Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Monitorimit të Shërbimeve dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

GRUPI I PUNËS

Boreta Murati



Sara Çobo



Françeska Gjata



KRYETARI
Faton Duro